



# PJESËMARRJA QYTETARE NË VENDIMMARRJE NË NIVEL LOKAL

**Misioni i ATRC-së**

Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC) është organizatë jofitimprurëse kosovare që punon për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile në vendim-marrje, si kusht për një shoqëri të zhvilluar demokratike dhe stabile rajonale.

ATRC ndihmon në forcimin e rolit të OJQ-ve si agjent të ndryshimit në shoqëri, ngritë kapacitetin e OJQ-ve dhe iniciativave qytetare që të ndërrmarin kampanja të avokimit dhe kontribuon në krijimin e institucioneve qeverisëse që i takojnë standardeve ndërkombëtare.

ATRC punon me përfaqësues të OJQ-ve, iniciativat qytetare, administratën publike dhe me institucionet politike pa dallim feje, gjinie, etnie, moshe, aftësie, përkatësie politike dhe orientimi seksual.

ATRC realizon qëllimet e veta përmes avokimit, ngritjes së kapaciteteve, shkëmbimit të informatave dhe rrjetëzimit në Kosovë e jashtë saj.

## **PËRMBAJTJA**

<b>Hyrje</b> .....	<b>1</b>
<b>Përmbledhje e përgjithshme</b> .....	<b>2</b>
<b>QËLLIMI</b> .....	<b>2</b>
<b>PROMOVIMI I PJESEMARRJES QYTETARE</b> .....	<b>3</b>
<b>FAKTORËT QË NDIKOJNË NË PJESEMARRJE</b> .....	<b>4</b>
<b>MËNYRAT E PJESEMARRJES QYTETARE</b> .....	<b>4</b>
<b>HAPAT E PJESEMARRJES QYTETARE</b> .....	<b>5</b>
<b>INFORMIMI PUBLIK</b> .....	<b>5</b>
<b>Përfitimet</b> .....	<b>6</b>
<b>Sfidat dhe mësimet</b> .....	<b>6</b>
<b>EDUKIMI DHE KËSHILLIMI</b> .....	<b>6</b>
<b>Përfitimet</b> .....	<b>7</b>
<b>Sfidat dhe mësimet</b> .....	<b>7</b>
<b>AVOKIMI DHE SHPREHJA E ZËRIT TË QYTETARËVE</b> .....	<b>8</b>
<b>Mjetet për Avokim dhe shprehje e Zërit të Qytetarëve</b> .....	<b>8</b>
<b>Përfitimet</b> .....	<b>8</b>
<b>Sfidat dhe mësimet</b> .....	<b>9</b>
<b>DIALOGU PUBLIK</b> .....	<b>9</b>
<b>Mjetet në Kategorinë e Dialogut Publik</b> .....	<b>9</b>
<b>Përfitimet</b> .....	<b>10</b>
<b>Sfidat dhe mësimet</b> .....	<b>11</b>
<b>TRANSPARENCA ZGJEDHORE DHE LLOGARIDHËNIA</b> .....	<b>11</b>
<b>Mjete nën Transparencën Zgjedhore dhe Kategoritë e Përgjegjësisë</b> .....	<b>12</b>
<b>Përfitimet</b> .....	<b>12</b>
<b>Sfidat dhe mësimet</b> .....	<b>12</b>
<b>POLITIKA DHE PLANIFIKIM</b> .....	<b>13</b>
<b>Mjetet në politikën dhe Kategoria Planifikimit</b> .....	<b>14</b>
<b>Përfitimet</b> .....	<b>15</b>
<b>Sfidat dhe mësimet</b> .....	<b>15</b>

<b>BUXHETET PUBLIKE DHE SHPENZIMET .....</b>	<b>16</b>
<b>Mjetet në kategorinë e buxheteve dhe shpenzimeve publike .....</b>	<b>17</b>
<b>Përfitimet.....</b>	<b>18</b>
<b>Sfidat dhe mësimet.....</b>	<b>18</b>
<b>MONITORIMI DHE VLERËSIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE .....</b>	<b>18</b>
<b>Përfitimet.....</b>	<b>19</b>
<b>Sfidat dhe mësimet.....</b>	<b>19</b>
<b>MBIKËQYRJA PUBLIKE .....</b>	<b>19</b>
<b>Mjetet e mbikëqyrjes publike.....</b>	<b>20</b>
<b>Përfitimet.....</b>	<b>20</b>
<b>Sfidat dhe mësimet.....</b>	<b>21</b>

## Hyrje

Koncepti i pjesëmarrjes qytetare daton nga lashtësia. Dëshmi të shkruara të pjesëmarrjes qytetare datojnë nga shekujt tetë dhe shtatë para erës sonë në qytet-shtetet greke. Pjesëmarrja në kuvendet e këtyre njësive qeverisëse ishte e hapur për të gjithë qytetarët e lirë, meshkuj më të vjetër se 18 vjeç. Kuvendet e qytetarëve thirrreshin për qëllim të debatit, arritjes së konsensusit dhe vendim-marrjes demokratike. Demokracia athiniane ka përfunduar në vitin 322 para erës sonë dhe nuk ka arritur të riaktivizohet për rreth dy mijë vjet. Modele të thjeshta të pjesëmarrjes qytetare janë paraqitur aty këtu gjatë mesjetës, pas shpërbërjes dhe ndarjes së Perandorisë Romake, kur artizanët urbanë organizoheshin në shoqata për të kontrolluar çështjet publike që kishin të bënin me punën e tyre. Ata themelonin rrethe të ngushta në formë të oligarkive me forma dhe rituale të ndryshme të votimit dhe pjesëmarrje të kufizuar të qytetarëve. Së fundi, pjesëmarrja e drejtpërdrejtë qytetare filloi të ri-paraqitet në shtet-qytetet e Italisë së renesancës, në kuvendet popullore të qyteteve angleze të shekullit të nëntë dhe në kantonet dhe komunat e Zvicrës në shekullin e XIII.

Kur demokracia u rivendos si sistem politik më shumë se 2.000 vjet më vonë, fuqia e vendim-marrjes nuk qëndronte te popullit por te përfaqësuesit e zgjedhur, duke krijuar kështu sistemin e demokracisë përfaqësuese. Tek në shekullin e XX filloi implementimi praktik i demokracisë pjesëmarrëse, edhe pse në shkallë të vogël. Ajo fitoi vëmendje akademike nga vitet 1980 dhe ende është duke u përhapur si në demokracitë e reja, po ashtu edhe në ato me traditë më të gjatë. Demokracia pjesëmarrëse është proces që kërkon përfshirje të gjerë të qytetarëve dhe grupeve të interesit në udhëheqjen dhe drejtimin e sistemeve politike. Ajo synon të krijojë sa më shumë hapesire për përfshirje të qytetarëve për të dhënë kontribute në vendim-marrje dhe njekohesisht ofron mundësi për të zgjeruar rrethin e njerëzve që kanë qasje në atë proces.

Ne Kosovë, pjesëmarrja qytetare, është e rregulluar dhe e garantuar me Kushtetutën dhe ligji. Neni 45 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës garanton te drejtën e publikut për të ndikuar në vendimet e institucioneve të shtetit, citojmë: Neni 45 i Kushtetutës: "Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike". Ligji për Vetëqeverisje Lokale bazohet mbi parime të garantimit të pjesëmarrjes së publikut në vendim-marrje, përmes përcaktimeve ligjore të mënyrave të komunikimit në mes të qytetarëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur. Ligji për vetëqeverisje lokale karakterizon takimet e kuvendit të komunës dhe të gjitha komisioneve të tij si të hapura për opinion. Ligji parasheh që komunat të mbajnë së paku dy takime publike në vit, ku mund të marrë pjesë secili person apo organizatë me interes në komunë. Këto takime shërbejnë si mjet informues për qytetarët, por edhe si mekanizëm për marrjen e sugjerimeve nga ana e përfaqësuesve të zgjedhur komunalë. Neni 68.3 i ligjit për vetëqeverisje lokale obligon komunat që t'i informojnë qytetarët e komunës për çfarëdo planesh apo programesh me interes publik.

Ligji për vetëqeverisje lokale përcakton dhe disa nga mekanizmat e pjesëmarrjes qytetare në drejtimin e politikave dhe vendimeve në nivelin lokal të qeverisjes. Sipas dispozitave të ligjit qytetarët kanë të drejtë për peticioni, iniciative qytetare, kërkesa për referendum komunal etj. Përveç kësaj, komunat këshillohen të themelojnë komitete këshillëdhënëse me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes qytetare në procesin e vendim-marrjes në sektore të caktuara.

### **Përmbledhje e përgjithshme**

Pjesëmarrja qytetare nënkupton përfshirjen e qytetareve, grupeve të interesit, komunitetit në përgjithësi, në proceset vendimmarrëse me qëllim të krijimit ose përmirësimit të politikave publike, procedurave dhe praktikave lokale në favor të krijimit mireqenjes së qytetareve. Strategjitë e avancuara për pjesëmarrjen publike, promovojnë përgjegjësinë, rrisin besimin dhe forcojnë përkushtimin e vendim-marrësve drejt përmirësimit të qeverisjes dhe kufizojnë praktikën korruptive. Pjesëmarrja qytetare si synim ka bashkërendimin dhe koordinimin e veprimeve në mes institucioneve, shoqërisë civile, sektorit privat dhe publikut në përgjithësi. Niveli i pjesëmarrjes së publikut në qeverinë lokale shpesh përdoret si indikator për të vlerësuar nivelin e demokracisë dhe respektimit të ligjit në institucionet e shtetit.

Edhe pse pjesëmarrja qytetare është obligim kushtetues dhe ligjor, megjithatë zbatimi i saj në praktikë përcillet me sfida dhe vështirësi. Pjesëmarrja aktive e qytetareve kërkon, informacione, aftësi, mjete financiare dhe kohë. Praktika e deritashme ka dëshmuar se qytetarët janë me shumë të interesuar për pjesëmarrje në vendimmarrje lokale në ato raste kur vendimi prek drejtpërdrejtë interesat e ngushta të tyre, familjes dhe rrethit ku ata jetojnë. Shpesh qytetarët i japin prioritet sigurimit të mbijetesës së familjeve të tyre dhe nuk kanë kohë për angazhim serioz në procesin e qeverisjes lokale. Sigurimi i informatave online, përmes web-faqeve dhe formave tjera elektronike, siç janë vendimeve, rregulloret dhe dokumenteve tjera me rendësi, është një mënyrë alternative e marrjes së informacionit dhe përfshirjes në vendimmarrje.

### **QËLLIMI**

Qëllimi i pjesëmarrjes qytetare është të promovojë transparencën, të inkurajojë qeverisjen e hapur dhe të krijojë pronësi qytetare në politikën publike. Përveç kësaj, pjesëmarrja publike:

- Krijon hapësirën për vendimmarrje të përbashkët: institucionale - qytetare.
- Rrit njohuritë e qytetarëve në lidhje me mënyrën e funksionimit të institucioneve dhe njëkohësisht krijon mekanizmat për monitorimin e procesit të vendim-marrjes në të njëjta institucione.
- Krijon mundësi publikut për pjesëmarrje në programet dhe projektet zhvillimore.

## **PROMOVIMI I PJESËMARRJES QYTETARE**

Nder faktoret me rendesi qe duhet te merren parasysh gjate procesit te pergatitjes se strategjise per rritjen e pjesemarrjes se publikut ne procesin e vendim-marrjes, eshte edhe perceptimi dhe niveli i besimit te qytetareve ne qeverine lokale. Komunitet e Kosovës, ne perputhje me Ligjin per Veteqeverisjen Lokale kanë krijuar mekanizmat ligjore per përfshirje te qytetarëve ne qeverisjen e nivelit lokal, siç janë dëgjimet publike dhe komitetet këshillëdhënëse ku qytetarët mund të japin kontributin e tyre në drejtimin e politikave publike. Përveç këtyre, qeveritë lokale mund të përfshijnë qytetarët edhe në grupe studimore, të cilat mund të ofrojnë kornizat për zhvillimin e qëllimeve afatgjata të qeverisjes së mirë, komitetet për kontratat qeveritare, ku qytetarët mund të jenë pjesë e komisioneve përzgjedhëse apo komiteteve mbikëqyrëse të implementimit të tyre. Këto komisione apo komitete mund t'i japin formë kulturës të kontraktimit qeveritar. Mekanizëm tjetër për përfshirjen e qytetarëve në qeverinë lokale është përmes grupeve publike mbikëqyrëse, të cilat për dallim nga komitetet këshillëdhënëse nuk kanë ndonjë lidhje me qeverinë. Këto grupe monitorojnë zbatimin e politikave të qeverisë dhe ngrisin zërin kundër propozimeve të politikave publike që janë në kundërshtim me vlerat demokratike të komunës në fjalë.

Kontribut konkret ne sigurimin e pjesemarrjes publike ne vendimmarrje, mund te japin jo vetem institucionet publike por edhe akteret tjere jo-insitucional. Si akter i parë, qeveria lokale ka përgjegjësinë ligjore për të udhëhequr në sigurimin e mundësive për përfshirjen e publikut. Vendimin për të përfshirë qytetarët, për shembull, në komitetet kontraktuese i merr qeveria. Po ashtu edhe suksesi dhe efektiviteti i dëgjimeve publike, komiteteve këshillëdhënëse dhe formave tjera të organizimit varet në masë të madhe nga përkushtimi i qeverisë ndaj transparencës dhe pjesemarrjes publike. Akter me rëndësi në promovimin e përfshirjes se publikut në procesin e vendim-marrjes janë edhe Organizatat e Shoqërisë Civile. Ato kanë mundësinë të tejkalojnë rolin e tyre të monitorimit dhe të mobilizojnë publikun në përkrahje apo kundërshtim të politikave, programeve dhe projekteve. Ato në shumicën e rasteve udhëheqin grupet monitoruese dhe këshillëdhënëse dhe koordinojnë aktivitetet e grupeve të tilla, prandaj ato kanë rol themelor në krijimin e kulturave pjesemarrëse te qytetarëve. Sektori privat është një akter tjetër, që është duke fituar rëndësi në çështjet civile, si përmes pjesemarrjes në programet zhvillimore, po ashtu edhe në partneritetet publiko-private. Sektori privat mund të rritë ndikimin e vet duke përkrahur fushatat informuese përmes mediave dhe duke luajtur rol aktiv në komitetet këshillëdhënëse.

## **FAKTORËT QË NDIKOJNË NË PJESËMARRJE**

Edukimi është njëri ndër faktorët kryesorë që përcakton nivelin e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendim-marrjes. Në përgjithësi, sa më i lartë niveli i edukimit të një personi, aq më e lartë mundësia që ai/ajo të merr pjesë në vendimmarrje. Arsyeja për këtë mund të jetë ngase personat me nivel të lartë edukimit janë në gjendje të kuptojnë më mirë rëndësinë e përfshirjes qytetare në procese, rëndësinë e përgjegjësisë qytetare, nevojën që kanë institucionet lokale për përvoja dhe mendime ndryshe, si dhe garantim të vendimeve në harmoni me kërkesat qytetare.

Mosha, përkatësia etnike, gjinore etj, janë po ashtu një faktor të cilat shpesh përcaktojnë edhe nivelin e pjesëmarrjes së tyre në proceset e qeverisjes demokratike. Arsyet për këtë shpesh lidhen me nivelin e pakënaqësive që ata kanë në raport me institucionet, mungesën e besimit, mos-përfaqësimin e interesave të tyre nga ana e institucioneve, përjashtimin nga procesi i diskutimit dhe vendimeve të rëndësishme publike etj.

## **MËNYRAT E PJESEMARRJES QYTETARE**

- Duke kërkuar informata në gazeta, revista dhe materiale të tjera dhe duke vlerësuar saktësinë e tyre.
- Duke votuar në zgjedhjet lokale dhe nacionale.
- Duke marrë pjesë në diskutime publike
- Duke nënshkruar peticione.
- Duke u shkruar letra përfaqësuesve të zgjedhur.
- Duke lobuar për ligje të interesit të veçantë.
- Duke ngritur zërin nëpërmjet marsheve, bojkoteve, apo formave tjera të protestës.
- Duke garuar në zgjedhje.
- Duke mbajtur post publik.
- Pa-degjueshmeri qytetare, dhe duke pranuar konsekuencat për të demonstruar që një ligj apo politikë është e padrejtë.



## **HAPAT E PJESËMARRJES QYTETARE:**

1. **Informimi i publikut.** Nënkupton mundësimi i qasjes së qytetarëve në informata lidhur me politikën, vendimet dhe veprimet e qeverisë.
2. **Edukimi dhe këshillimi,** Nënkupton informimin e qytetarëve lidhur me të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.
3. **Avokimi dhe zëri i qytetarëve** është një ndër aspektet thelbësore të pjesëmarrjes qytetare, që për qëllim ka të ndihmojë qytetarët të shprehin mendimet dhe brengat e tyre publikisht.
4. **Dialogu publik** në mes të qytetarëve dhe qeverisë përbën një aspekt të rëndësishëm të pjesëmarrjes qytetare.
5. **Votimi** është e drejtë dhe përgjegjësi qytetare dhe njekohesisht njihet si forma themelore e pjesëmarrjes qytetare.
6. **Politikat dhe planifikimi** janë detyra kryesore e secilës qeveri për të dizajnuar dhe zbatuar ne praktike rritjen e efektivitetit të programeve qeveritare ndaj prioriteteve dhe nevojave të qytetarëve
7. **Menaxhimi transparent, i përgjegjshëm, efektiv dhe efikas i buxheteve dhe shpenzimeve publike** është çelësi i qeverisjes së mirë dhe një nga arsyet për rritje ose rënie të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje.
8. **Monitorimi dhe vlerësimi i shërbimeve publike** ofron mundësinë e pjesëmarrjes qytetare në përmirësimin e këtyre shërbimeve, të cilat janë esenciale për mirëqenien dhe mbijetesën e publikut.
9. **Mbikëqyrja publike** ndihmon të luftohen korrupsioni, patronazhi dhe mungesa e përgjegjësisë në mesin e institucioneve publike.

## **INFORMIMI PUBLIK**

Informimi i publikut është një element kyç i qeverisjes me pjesëmarrje, ngase pjesëmarrja e qytetarëve/shoqërisë civile, transparenca dhe llogaridhënia në politikë dhe qeveri janë thjesht të pakonceptueshme pa informata. Qasja joadekuatë publike në informata hap rrugën për praktika korruptive dhe marrëveshje të fshehta. Liria e informimit është e njohur si një e drejtë themelore e njeriut dhe qasja e qytetarëve në informacion është përshëndetur si gurë-themel i demokracisë në tërë globin. Liria e informimit është konsideruar edhe si vendimtare në sigurimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tjera kulturore, sociale, ekonomike dhe politike dhe në nxitjen e barazisë së zhvillimit dhe humanitetit. Rritja e qasjes qytetare në informata është një hap i parë i rëndësishëm drejt fuqizimit të qytetarëve për të marrë pjesë në mënyrë efektive në proceset e qeverisjes. Në Kosovë, kjo çështje është rregulluar me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, i cili përcakton qartë detyrimet të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente publike dhe obligon institucionet e republikës së Kosovës të sigurojnë qasjen e publikut në to.

Ekzistojnë disa mjete që mund të përdoren për të rritur qasjen e publikut në informata, si dhe për të rritur interesimin qytetar për t'u shërbyer me të drejtën e tyre për informim. Mjetet kryesore të kategorisë së informimit publik janë:

- **Avokimi për Qasje në Informata** - Ky është një grup i strategjive të avokimit dhe metodologjive që synojnë mobilizimin e vendim-marrësve, ligjvënësve dhe komuniteteve drejt rritjes së qasjes së publikut në informata, duke përfshirë lobimin për miratimin dhe zbatimin efektiv të legjislacionit për lirinë e informacionit, duke informuar qytetarët rreth të drejtave të tyre për informim dhe promovimin e kërkesës proaktive për informacion.
- **Monitorimi i Qasjes në Informata** – Monitorimi i qasjes në informata është një grup prej tre instrumenteve të dizajnuara për të mbledhur informata në lidhje me ligjet dhe praktikën e një vendi lidhur me lirinë e informatave. Së pari, një tabelë që siguron një bazë për vlerësimin e ligjeve dhe praktikave të një vendi kundrejt standardeve të përcaktuara ndërkombëtare. Së dyti, një metodologji monitoruese që mundëson standardizimin në dorëzimin e kërkesave për informata dhe llojet e informatave të kërkuara. Së treti, një softwer i projektuar posaçërisht për

të lejuar shumë partnerë nga vende të ndryshme për të futur të dhëna në format të njëjtë, që lejojnë analiza krahasuese të rezultateve.

- **Mjetet për të Mbështetur Transparencën** - Ky grup i mjeteve fokusohet në nxitjen e transparencës dhe qasjes në informata, me theks të veçantë në qeverisjen lokale duke ngritur kapacitetin e Organizatave të Shoqërisë Civile dhe agjencive të qeverisjes vendore.
- **Lehtësimi i Shpërndarjes së Informatave Publike** - Ky grup i mjeteve jep udhëzime se si të sigurohet zbatimi i ligjit për lirinë e informimit publik. Ai jep këshilla edhe për autoritetet publike (në nivel kombëtar dhe lokal) dhe OSHC-të në lidhje me vendosjen e marrëveshjeve adekuate për shpërndarjen e informatave relevante publike dhe krijimin e mekanizmave dhe procedurave që u mundësojnë qytetarëve qasjen në informata.

### **Përfitimet**

Përfitimet kryesore nga informimi publik janë:

- Sigurimi dhe mbrojtja e të drejtave të qytetarëve për informata.
- Zvogëlimi i korrupsionit, përmes rritjes së transparencës dhe llogaridhënies.
- Kontributi në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe drejtësisë sociale.
- Nxitja e një qytetarie të informuar, duke lehtësuar pjesëmarrjen efektive qytetare në proceset e planifikimit publik dhe vendim-marrje.

### **Sfidat dhe mësimet**

- Legjislacioni për lirinë e informimit është i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm për të siguruar qasjen në informata.
- Vullneti politik është vendimtar për të realizuar te drejtën e qasjes në informata.
- Duke pasur parasysh ngurrimin e shpeshtë të autoriteteve publike për të publikuar informatat dhe kulturën mbizotëruese të sekretit zyrtar në shumë vende, kërkesa proaktive nga qytetarët është e rëndësishme për rritjen e qasjes në informata.
- Qasja në informata duhet të balancohet me nevojën për të mbrojtur privatësinë individuale dhe lirinë.
- Shpërndarja publike e informatave ka një efekt të rëndësishëm, i cili reflektohet në transparencën dhe hapat tjerë të qeverisjes me pjesëmarrje.

### **EDUKIMI DHE KËSHILLIMI**

Edukimi civil, i njohur edhe si edukimi qytetar ose arsimim mbi demokracinë ka për qëllim për të pajisur dhe fuqizuar qytetarët për të marrë pjesë në proceset demokratike dhe mbështetjen e qeverisjes demokratike dhe pjesëmarrëse. Nëpërmjet edukimit qytetar, jo vetëm që krijohet një kërkesë për qeverisje të mirë, por edhe një qytetari që është informuar dhe të angazhuar në një proces të diskutimit në sferën publike. Edukimi qytetar është paraprirës i formave këshilluese të pjesëmarrjes duke përgatitur qytetarët e rinj dhe të vjetër lidhur vlerat përkatëse qytetare, aftësitë, qëndrimet dhe prirjet, duke rritur kështu kapacitetet e tyre për të qenë qytetarë të fuqizuar dhe vendim-marrës.

Një dallim i rëndësishëm në mes të mënyrave këshilluese të pjesëmarrjes publike dhe formave konvencionale të "konsultimit", si anketat, dëgjimet publike dhe periudhat për komente publike të përdorura nga qeveria është që shqyrtimi i kushton rëndësi përpunimit të informatave, që do të thotë

që informatat të kenë kuptim në vend të vetëm këmbimit të thjeshtë të informatave. Mjetet e këshillimit jo vetëm që u japin qytetarëve informata objektive dhe u mundësojnë atyre të kuptojnë përfitimet midis zgjedhjes së politikave të ndryshme, por edhe lehtësojnë dialogun e strukturuar si ndihmë për të sqaruar vlerat dhe prioritetet e tyre, për të shqyrtuar një gamë të gjerë të politikave alternative dhe të shprehin preferencat në mënyrë të informuar. Mjetet këshilluese parashohin shkallë dhe nivele të ndryshme të përfshirjes së qytetarëve, disa prej të cilave janë të kufizuara në shkëmbimin e informatave dhe qasjet konsultative, ndërsa të tjerat janë më shumë metoda fuqizuese ku qytetarëve u jepen të drejta të ndryshme dhe autoritet për të marrë vendime përfundimtare.

### **Përfitimet**

Përfitimet e metodave edukative dhe këshilluese të qeverisjes pjesëmarrëse përfshijnë:

- Qytetarë të ditur, të aftë, vendim-marrës dhe aktivë, me një potencial të madh afatgjatë për nivelet në rritje të angazhimit qytetar dhe pjesëmarrjes politike.
- Krijimi i mundësive për qytetarët që të formojnë dhe, në disa raste, do të përcaktojnë politikat publike.
- Rritja e pronësisë publike mbi procesin e zhvillimit të politikave që rezultojnë në preferencat e përbashkëta politike të të gjitha grupeve / seksioneve të ndryshme të shoqërisë, duke minimizuar kështu fërkimet ndërmjet interesave dhe maksimalizuar pranimin e politikave dhe zbatimin efektiv të tyre.
- Politika dhe programe publike të informuara mirë, të fuqishme dhe të drejtë .
- Rritja e besimit publik në qeverinë dhe sinergji në mes të shtetit dhe shoqërisë civile.

### **Mësimet**

Metodat edukative dhe këshilluese u lejojnë grupeve të qytetarëve që të vijnë së bashku për të mësuar, diskutuar dhe zhvilluar një kuptim të përbashkët mbi një çështje nëpërmjet shqyrtimit të fakteve relevante nga këndvështrime të ndryshme. Ato favorizojnë dijen e bazuar në përvojë mbi "njohuritë e ekspertëve", për të ndihmuar në formimin e politikave publike dhe programeve. Ato nxisin nivele të thella të dijes në mesin e qytetarëve lidhur me një politikë të veçantë ose çështje të programit dhe shpesh theksojnë cilësinë dhe thellësinë e asaj njohurie mbi thellësinë dhe shpeshhtësinë e diskutimit. Megjithatë, në të njëjtën kohë, si shumica e qasjeve të qeverisjes me pjesëmarrje, metodat këshilluese janë më të efektshme kur institucionalizohen dhe zbatohen në baza të shpeshta dhe të vazhdueshme.

Metodat edukative dhe këshilluese janë gjithashtu të njohura edhe se ballafaqohen me problemin e "kapjes së elitave" duke i lejuar grupet më dominante në shoqëri të monopolizojnë hapësirat vendim-marrëse, duke dekurajuar pjesëmarrjen e grupeve marginalizuara si dhe grupeve më të dobëta të shoqërisë, të cilët në fakt janë fokusi kryesor i qasjeve të tilla. Prandaj, metodat edukative dhe këshilluese duhet hartuar duke marrë parasysh pengesat socio-ekonomike dhe kulturore që ekzistojnë në shoqëritë e ndryshme.

Këshillimi demokratik mund të zbatohet në një varg kontekstesh, si online dhe ballë për ballë, brenda dhe jashtë qeverisë. Teknikat dhe mjetet e këshillimit mund të përdoren gjatë gjithë ciklit të qeverisjes publike nga vendosja e rendit të ditës, hartimin e politikave dhe të vlerësimit të programit.

### **AVOKIMI DHE SHPREHJA E ZËRIT TË QYTETARËVE**

*Mjetet e përfshira në këtë kategori janë të menduara për të forcuar zërin e qytetarëve në procesin e vendim-marrjes përmes pjesëmarrjes së tyre të drejtpërdrejtë.*

Avokimi është definuar si "proces, gjate te cilit nje grup i qytetareve, te organizuar rreth nje ceshtje te caktuar, ne menyre strategjike, ndikojne ne vendimarrje per te zgjidhur nje problem konkret te komunitetit. Një shumicë e madhe e njerëzve në të gjithë botën janë të marginalizuar dhe përjashtuar nga mundësia për të shprehur mendimet, shqetësimet dhe nevojat e tyre në proceset e vendim-marrjes që dukshëm ndikojnë në jetën e tyre. Avokimi, në këtë kontekst, synon të plotësojë zërat e njerëzve të zakonshëm dhe t'i fuqizojë ata për të marrë pjesë në mënyrë efektive në politikat publike dhe vendim-marrje. Në kundërshtim me mënyrat tradicionale të avokimit, si lobimi dhe analizat e politikave, të cilat janë të dominuara nga ekspertët teknikë që kërkojnë të mbrojnë "në emër" të popullit, mjetet në këtë pjesë vendosin thelbin në ngritjen e kapaciteteve të qytetarëve të zakonshëm për t'iu qasur informatave, të mobilizohen, krijojnë rrjete dhe të forcojnë përfaqësimin e tyre në forumet përkatëse për të ndikuar strategjikisht në proceset qeverisëse.

Megjithatë, natyra e pjesëmarrjes së popullit në këto iniciativa avokuese sillet nga të qenit shumë pasiv deri në aktivizëm të plotë, varësisht nga lloji i çështjeve me të cilat ata merren dhe fushëveprimeve hapësinore të fushatave advokuese. Iniciativat lokale / në nivel të komuniteti, për shembull, theksojnë transformimin social dhe kanë tendencë të nxisin pjesëmarrjen aktive të qytetarëve nëpërmjet mobilizimit të komunitetit. Iniciativat kombëtare / regjionale të cilat përdorin anketat apo referendumet ku pjesëmarrja e njerëzve, edhe pse e drejtpërdrejtë, është mjaft pasive.

### **Mjetet për Avokim dhe shprehje e Zërit të Qytetarëve**

Aktivitetet e cdo fushate avokimi duhet te ndahen ne faza, si:

- faza e hulumtimit, gjetjes se informatave per problemit e identifikuar
- faza e ndergjegjesimit te opinionit dhe vendimmarresve
- faza e presionit – avokimit te drejteperdrejte, per t'i bindur vendimmarresit per ndermarrjen e veprimeve, permes organizimit te aktiviteteve konkrete, te cilat duhet te kene synim presionin ne zyrtare ose insitucione per te inicuar, ndryshuar vendimet dhe praktikat institucionale.
  
- faza e monitorimit, vleresimit dhe ri-dizajnimimit te aktiviteteve

### **Përfitimet**

- U mundëson njerëzve të kundërshtojnë dhe të luftojnë pabarazinë dhe padrejtësinë sociale, duke fuqizuar dhe transformuar ata gjatë këtij procesi në nivele të ndryshme të gjeo-politikave.
- Ndihmon në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
- Promovon transparencën, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien në qeverisje publike
- Promovon formimin e koalicioneve dhe solidaritetin mes organizatave të shoqërisë civile.

- Lehtëson vendimet publike dhe promovon politikat publike që nuk janë vetëm të përgjegjshme dhe që reflektojnë për njerëzit, por që janë të nxitura edhe nga hulumtimet e bazuara në dëshmi shkencore.
- Forcon zërin e qytetarëve për të shprehur pikëpamjet, mendimet dhe shqetësimet e tyre në një gamë të gjerë çështjesh që kanë të bëjnë me qeverisjen publike.

### **Sfidat dhe mësimet**

- Nismat avokuese kërkojnë kohë dhe burime dhe për këtë arsye mbajtja e hovit dhe interesimit të konstituentëve që të qëndrojnë të mobilizuar është një sfidë e madhe.
- Shumë nga grupet që fillojnë iniciativa avokuese mund të mos kenë një kuptim të qartë, ose të thellës të çështjeve politike dhe shoqërore të përfshira që ndikojnë mbi ndryshimin social, që pengon aftësinë e tyre për të planifikuar iniciativa efektive avokuese.
- Përpjekjet e Avokimit përqëndrohen ekskluzivisht në ndryshimin e legjislacionit dhe të politikave.
- Për shkak të fokusit të tepruar në politika dhe ligje, shumë grupe të avokimit përfundojnë duke mos vërejtur rolin vendimtar të pjesëmarrjes dhe udhëheqjes nga ana e të varfërve dhe të marginalizuarve dhe u duket më e lehtë të udhëheqin fushatat vetë.
- Avokimi i fokusuar në politika shpesh injoron nevojën për të forcuar zërin e grupeve të marginalizuara në vendim-marrje.
- Një mësim i madh ka të bëjë me ekuilibrin në mes të ndikimit/arritjes së ndonjë ndryshimi dhe fuqizimit të grupeve të marginalizuara. Përveç analizës së politikave, aktiviteteve hulumtuese dhe lotuese, kjo kërkon edhe dhënien adekuate të vëmendjes strategjive organizuese dhe mobilizuese si arsimi publik, ngritja e vetëdijes, zhvillimi i lidershipit, dhe ndërtimi i koalicioneve.

### **DIALOGU PUBLIK**

Dialogu publik mund të konsiderohet si një nga themelet e qeverisjes me pjesëmarrje. Ofrimi i mundësisë njerëzve për të dëgjuar, mësuar dhe diskutuar nxit një mjedis të pjesëmarrjes aktive, përfshirëse. Kjo do të fuqizojë pjesëtarët e komuniteteve që në mënyrë konstruktive të ndikojnë në jetën e tyre të përditshme. Në të njëjtën kohë, dialogu publik ofron një mjet efektiv për hartuesit e politikave për t'u informuar në lidhje me shqetësimet, nevojat dhe prioritetet e komunitetit. Ai shërben për të gjetur mënyrat në të cilat kërkesat e komunitetit mund të trajtohen në mënyrë efektive.

Dialogu është një mënyrë e veçantë e komunikimit pasi gjeneron bashkëveprim të mirëfilltë përmes të cilit njerëzit e dëgjojnë njëri-tjetrin me qëllim të ndryshimit të opinioneve të tyre nga ajo që ata mësojnë. Organizuar në mënyrë efektive, mjetet publike të dialogut mund të nxisin një shumëllojshmëri të gjerë të proceseve shoqërore si në afat të shkurtër dhe në afat të gjatë, duke përfshirë demokratizimin dhe ndërtimin e paqes dhe pajtimit të proceseve, duke çuar në transformimin social dhe politik.

### **Mjetet në Kategorinë e Dialogut Publik**

*Ka tetë mjete në këtë kategori. Ato janë:*

- **Dialogu Multi-akterësh** synon që të sjellë palët e interesuara, ose ata që kanë një 'hise' në një çështje të caktuar ose vendim, në kontakt me njëri-tjetrin. Objektivi kryesor i këtij dialogu është

rritja e nivelit të besimit ndërmjet aktorëve të ndryshëm, për të ndarë informata dhe njohuri institucionale, si dhe për të gjeneruar zgjidhje dhe praktika përkatëse të mira.

- **Dialogu gjenerues** është një mënyrë që njerëzit të shprehin supozimet, besimet, dhe vlerat e tyre të pathëna rreth botës në mënyrë të pavetëdijshme. Qëllimi i dialogut është që të rrisë gjenerimin e të kuptuarit të pjesëmarrësve të supozimeve të tyre, si edhe ato të partnerëve të tyre për dialog.
- **Dialogu i qëndrueshëm** është një proces i vazhdueshëm që ndërtohet mbi cilësitë transformuese të dialogut dhe u mundëson pjesëmarrësve që sistematikisht dhe gradualisht të provojnë dhe të merren me shkaqet e konfliktit të thellë të njeriut.
- **Biseda publike** është një formë e dialogut e projektuar për të trajtuar tema thellësisht përçarëse, që synojnë rritjen e mirëkuptimit të ndërsjellë, duke përmirësuar komunikimin dhe ndërtimin e marrëdhënieve më konstruktive dhe bashkëpunuese.
- **Facilitimi** vjen nga rrënja e vjalës latine 'facil' që do të thotë 'lehtë' dhe është e menduar mbi të gjitha për të bërë gjërat më të lehta, hapjen e rrugës, si dhe arritjen e objektivave. Ajo del nga njohja se si njerëzit sillen në grupe dhe siguron që tendencat e pjesëmarrësve për të dalë nga tema, për të mos dëgjuar të tjerët, ose duke shmangur përfshirjen të menaxhohen si duhet.
- **Ndërmjetësimi** është një formë e zgjidhjes alternative të kontesteve dhe synon të ndihmojë palët e shumta kundërshtarë në arritjen e një marrëveshjeje. Nëse një marrëveshje rezulton apo jo në dicka të pranueshme për të gjithë, si dhe për përmbajtjen e marrëveshjes, vendosin palët në konflikt apo kundërshtim. Prandaj, ndërmjetësimi nënkupton arritje të marrëveshjes në vend të ajo të imponohet nga ndonjë palë e tretë. Ndërmjetësuesit përdorin teknika të përshtatshme dhe / ose aftësi për të hapur dhe / ose përmirësuar dialogun mes palëve kundërshtuese, me qëllim që të ndihmojnë palët të arrijnë një marrëveshje mbi çështjen e kontestuar.
- **Dëgjimet publike** janë takime ku ankesat specifike apo shqetësimet janë transmetuar para një jurie, një zyrtari, ose paneli / komision. Zyrtarët qeveritarë të interesuar marrin pjesë për të paraqitur përgjigjet e tyre për ankesat / shqetësimet e transmetuara. Pas dëgjimit të ankesave / shqetësimeve dhe përgjigjeve zyrtare, juria apo paneli kalon urdhra, apo udhëzime.
- **Seancat e varfërisë** janë forume të dialogut që ofrojnë mundësi për njerëzit e varfër të flasin dhe të artikulojnë nevojat, problemet dhe pikëvështrimet e tyre. Seancat e varfërisë gjithashtu inkurajojnë personat me pushtet, autoritet dhe përvojë të dëgjojnë zërat e të varfërve.

### Përfitimet

- Dialogu Publik promovon diskutimin dhe partneritetin ndërmjet grupeve të ndryshme të interesuara.
- Gjeneron kuptim të zgjeruar të pozicioneve dhe perspektivave të ndryshme.
- Ndërton besimin dhe marrëdhëniet mes komuniteteve të ndryshme, grupeve të interesit, si dhe në mes të palëve të interesuara dhe vendim-marrësve.
- Ndihmon vendim-marrësit të kuptojnë se çfarë dëshirojnë komunitetet dhe pse.
- Rrit transparencën dhe llogaridhënien në proceset qeverisëse.
- Mund të jetë efektiv në profilizimin dhe adresimin e nevojave specifike të çështjeve të grupeve të marginalizuara shoqërore, duke përfshirë gratë dhe njerëzit e varfër.

- Ndihmon në zgjidhjen e konflikteve dhe ndërtimin e paqes dhe transformimin e marrëdhënieve jofunkionale që pengojnë organizatat apo komunitetet të punojnë në mënyrë efektive.
- Sjell përfitime të tilla si shkrehje të tensionit, ulje të dhunës dhe një marrëdhënie shumë humane midis grupeve në konflikt.
- Siguron një hapësirë të veçantë për zgjidhjen e problemeve, ndarjen e njohurive dhe shembuj në prezantimin e praktikës së mirë.

### **Sfidat dhe mësimet**

- Sjellja e grupeve të ndryshme / komuniteteve mund të jetë problematike dhe shpesh ka pasoja sociale dhe politike.
- Mjetet e dialogut shpesh kërkojnë kohë dhe burime intensive. Është thelbësore që të bëhen aktivitete të vazhdueshme të dialogut që kërkojnë angazhim afat-gjatë.
- Shpesh, nuk ka lidhje direkte në mes të procesit të dialogut zyrtar dhe proceseve vendim-marrëse. Kjo mund të pengojë ndikimin e dialogut, dhe në afat të gjatë, të çojë në zhgënjimin e pjesëmarrësve.
- Në një kontekst të ndërlikuar politik, ka shumë faktorë ndikues dhe është shpesh e pamundur për të demonstruar një marrëdhënie të drejtëpërdrejtë në mes të dialogut dhe ndryshimeve të mëvonshme. Për më tepër, procesi dhe rezultatet e sjelljes nuk janë të matshme dhe për këtë arsye të vështirë për t'u identifikuar dhe dokumentuar.
- Është e rëndësishme të menaxhohen pritjet e pjesëmarrësve të dialogut.
- Një sfidë tjetër e rëndësishme është sigurimi për përfshirjen kuptimplotë të komuniteteve të marginalizuara dhe të pafavorizuara në procesin e dialogut.

### **TRANSPARENCA ZGJEDHORE DHE LLOGARIDHËNIA**

